



27 gusht 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Përvetësimi dhe devaluimi i parasë publike në Prizren

EC Ma Ndryshe edhe gjatë muajit gusht ka vazhduar me monitorimin e punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në fokus të monitorimit kanë qenë shpenzimet e qeverisë lokale në gjysmëvitin e parë 2012 dhe ndërtimet kolektive jashtë kriterëve urbanistike.

Ndonëse e paralajmëruar disa herë nga EC Ma Ndryshe dhe OJQ-të e tjera që të ketë kujdes me kategoritë e ndieshme buxhetore, qeveria lokale e Prizrenit edhe gjatë periudhës së parë të vitit fiskal 2012 nuk ka hezituuar që në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të shpenzojë afro 650.000 euro. Kabineti qeverisës i kryetarit të Komunës, në periduhën përkatëse ka shpenzuar mbi 112.000 euro për karburante për vetura, ndërsa për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre janë shpenzuar afro 32.000 euro. Një nga sjelljet më të papranueshme të zyrtarëve komunalë vazhdon të jetë edhe mënyra e përdorimit të telefonit zyrtar, pasi që monitorimi zbulon se për shpenzime të telefonisë mobile për periudhën gjashtë mujore janë shpenzuar mbi 15.000 euro. Për botimet dhe publikimet janë shpenzuar mbi 47.000 euro, derisa për drekat zyrtare dhe manifestimet e ndryshme afro 31.000 euro. Një detaj i çuditshëm që ka zbuluar monitorimi i shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë është kodi buxhetor 13670 për municion dhe armë zjarri, ku nga ana e qeverisë lokale të Prizrenit janë të shpenzuar 60 euro.

EC Ma Ndryshe javën e kaluar publikoi edhe informatën për shpenzime marramendëse për udhëtimet e zyrtarëve të komunës së Prizrenit. Apelin e javës së kaluar, po ia përsërisim kryetarit të Komunës: ai duhet të jetë i kujdesshëm në shpenzimin e parasë publike, pasi që ka obligim ligjor dhe moral që të menaxhojë me përgjegjësi paratë e taksapaguesve të Prizrenit. Karburantet e veturave, telefonja mobile, drekat zyrtare, udhëtimet zyrtare dhe të tjera kategori shpenzuese të buxhetit paguhen nga paratë publike, respektivisht nga taksat e qytetarëve të Prizrenit. Prandaj, në marrjen e vendimeve për shpenzime, kryetari i Komunës duhet t'i ketë parasysh standardet e qeverisjes së mirë dhe të menaxhimit adekuat me paratë publike. Në të njëjtën kohë, kryetari duhet të ketë parasysh se menaxhon me buxhetin e një komune me nivel mjaft të dobët të zhvillimit ekonomik dhe me tregues alarmant të niveleve të varfërisë (dhe varfërisë ekstreme), papunësisë dhe rasteve sociale.

Një dëshmi e prekshme e pabarazisë së madhe sociale që ekziston në Prizren dhe e shpenzimeve të shfrenuara të parasë publike nga qeveria lokale është kujdesi që kjo qeveri u tregon pacientëve të sëmurë dhe në kushte të vështira ekonomike për tretman adekuat mjekësor. Kohë pas kohe, kryetari i Komunës merr vendime për t'i ofruar ndihmë financiare kësaj kategorie të qytetarëve, ndërsa shuma maksimale që i ofrohet një pacienti është 300 euro. Edhe në vendimet për t'iu ndihmuar familjeve që jetojnë me asistencë sociale, qeveria lokale intervenon me shuma modeste. Mirëpo, kur bëhet fjalë për privilegjet e zyrtarëve komunalë – si telefoni, udhëtime, karburante, dreka – nuk vlen parimi i shpenzimit modest të parasë publike. Ndërsa ky përvetësim dhe devaluim i parasë publike nuk është fenomen i vitit 2012. Për shmebull, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare në vitin 2010 kanë qenë 110.000 euro, ndërsa në vitin 2011 afro 75.000 euro; për derivate dhe lëndë djegëse në vitin 2010 janë shpenzuar 717.000 euro, ndërsa në vitin 2011 rreth 713.000 euro; shpenzimet e reprezentacionit në vitin 2010 kanë qenë 84.000 euro, ndërsa në vitin 2011 – 91.000.

Qeverisja e keqe me paranë publike është konstatuar edhe nga Raporti 2011 i Auditorit të Përgjithshëm për komunën e Prizrenit, ndërsa shpenzimet e gjashëtmuorit të parë të vitit 2012 dëshmojnë se qeveria lokale nuk është e interesuar të përmirësojë menaxhimin e vet financiar. Kjo praktikë e shpenzimeve është në kundërshtim me realitetin social dhe ekonomik të qytetarëve të Prizrenit. Sa më të shfrenuara të jenë shpenzimet e zyrtarëve të qeverisë lokale për privilegjet e tyre, aq më e papërbalueshme do të jetë shporta ditore e ushqimit për familjet e Prizrenit. Ne tashmë i jetojmë dy realitete në Prizren, atë të zyrtarëve të qeverisë lokale që shijojnë privilegjet e pushtetit dhe të dytën, jetën e qytetarëve të Prizrenit, ku çdo i dytë qytetar jeton në varfëri, ndërsa cdo i pesti në varfëri ekstreme. Dhe e gjithë kjo, në emër të qytetarëve dhe përmes taksava të tyre.

EC Ma Ndryshe i rekomandon fuqishëm kryetarit të Komunës që të ndalojë këtë praktikë të përvetësimit dhe devalvimit të parasë publike. Një praktikë e këtillë po e thellon diskriminimin dhe pabarazinë sociale në Prizren, që është në kundërshtim të plotë me mandatin e tij si menaxher i zhvillimit të qytetit. Gjithashtu, i rekomandojmë Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe Kryesuesit që sa më parë të kërkojnë raportet financiare nga ana e kryetarit të Komunës për periudhën gjashtëmujore 2012. Qëllimi i këtij raportimi duhet të jetë rishqyrtimi i vijave buxhetore për vitin 2012 dhe shkurtimi i shpenzimeve në kategoritë e lartpërmendura.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajt vijues përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +386 49 116 448

Projekti "Transparenca on-line e komunës së Prizrenit" mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo